

Nis puna për restaurimin e kishës së Shën Ilias, objekt kulti 400 vjeçar



Bledi Naska/ Në fshatin Stegopull, Gjirokastër ka nisur puna për restaurimin e Kishës së Shën Ilias.

Kisha e Shën Ilias është rreth 400 vjeçare e ndërtuar në shek. XVII dhe konsiderohet si pjesë e rëndësishme e trashëgimisë kulturore në vendin tonë.

Lajmin për fillimin e punimeve në këtë objekt kulti e ka bërë të ditur ministria e Kulturës, Elva Margariti ku thekson se punimet restauruese në këtë kishë erdhën si pasojë e kërkesave të vazhdueshme të komunitetit të zonës.

“Pas kërkesave të vazhdueshme të komunitetit të zonës, ka nisur puna për restaurimin e Kishës së Shën Ilias, në fshatin Stegopull, Gjirokastër. Një monument i shek. XVII, i cili i ka rezistuar kohërave e zografisur nga dora e Kostandinit”, shprehet Margariti.

Puna restauruese në këtë objekt bën të ditur ministria konsiston në stabilizimin e strukturës së muraturave si dhe në ndërhyrje konsoliduese – restauruese në pikturën murale të interiorit.

“Projekti i hartuar nga specialistët e Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore

dhe financuar nga buxheti i shtetit, parashikon rishikimin e gjendjes dhe strukturës së çatisë së hajatit në anën perëndimore, pastrimin e territorit përreth, stabilizimin e strukturës së muraturave si dhe ndërhyrje konsoliduese – restauruese në pikturën murale të interierit”, bën të ditur Margariti.

Ky projekt i hartuar nga Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore do financohet nga fondet e buxhetit të shtetit me një vlerë prej 8 milionë lekësh të reja.

Kisha e manastirit të Shën Ilias është e vetmja e mbijetuar mes 13 kishave të fshatit Stegopull në Gjirokastrë. Kisha e një stili të rrallë arkitekturor mendohet se është një ndër më të vjetrat në rajon dhe ka njohur disa faza rindërtuese përgjatë shekujve.